

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 23101/20

Artur MALAJ

kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 shtator 2025, si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit*.

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 23101/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 11 qershor 2020 nga një shtetas shqiptar, z. Artur Malaj (“kërkuesi”), i cili ka lindur në vitin 1969, banon në Tiranë dhe u përfaqësua nga znj. T. Eatwell, dhe më pas nga z. S. Powels, një avokat i cili e ushtron profesionin në Londër;

vendimin për të njoftuar mbi ankesat, e bëra në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe të nenit 8 të Konventës, qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të shpallur të papranueshëm pjesën tjetër të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Në vitin 2016, gjyqtarët dhe prokurorët në Shqipëri iu nënshtruan procesit të vlerësimit kalimtar (“proces i *vetting*-ut”) pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (“KPK”) në shkallën e parë, dhe pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (“KPA”) (shih *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021). Çështja ka lidhje me procesin e *vetting*-ut që çoi në shkarkimin e kërkuesit nga gjyqësori.

A. Vendimi i KPK-së

2. Kërkuesi ka qenë gjyqtar që prej vitit 2002, së fundmi në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

3. Më 3 gusht 2018, KPK-ja e konfirmoi kërkuesin në detyrë. Ajo gjykonte se problematikat e vogla, në lidhje me pasurinë e tij nuk ishin mjaftueshëm serioze për të urdhëruar shkarkimin e tij nga detyra.

B. Procedurat pranë KPA-së

1. Apeli

4. Më 26 tetor 2018, Komisioneri Publik (“Komisioneri”), i cili përfaqësonte interesin publik gjatë procedurave (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 106) apeloj pranë KPA-së. Ai argumentonte se në deklarinë e pasurisë gjatë *vetting*-ut në vitin 2017, kërkuesi nuk kishte bërë publike një marrëveshje për rezervimin e një pasurie të paluajtshme (“Marrëveshja e Rezervimit”) dhe nuk kishte provuar se kishte mjaftueshëm kursime në atë kohë për të paguar këstin prej 15,130 eurosh (EUR), sipas asaj marrëveshjeje. Më 5 nëntor 2018, kërkuesi u përgjigj se marrëveshja ishte anuluar nga palët më 22 korrik 2005, dhe për pasojë ai nuk kishte arsye për ta deklaruar atë në deklarinë e tij në vitin 2017. Ai shtoi se nuk e kishte bërë pagesën e këtij kësti dhe bashkëngjiti një deklaratë në lidhje me këtë nga kompania e ndërtimit që ishte palë në marrëveshje.

5. Më 4 korrik 2019, Komisioneri paraqiti një shtojcë për apelimin e tij fillestar me pretendimin se kërkuesi nuk kishte mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe pasuritë e tij në periudhën midis vitit 2007 dhe 2011. KPA-ja ia përcolli shtojcën kërkuetit, i cili e kundërshtoi pretendimin.

6. Më 19 korrik 2019, KPA-ja dëgjoi argumentet e palëve në një seancë me dyer të hapura.

7. Në seancën e radhës të datës 6 shtator 2019, kërkuesi bëri parashtrime të detajuara, midis të tjerash, për çështjen e bashkëshortes së tij, një notere, që kishte përfutur nga një amnisti fiskale në vitin 2011 (shih paragrafin 22 në vijim). Në këtë seancë, KPA-ja vendosi, sipas kërkesës së Komisionerit, që të bënte një analizë të re financiare për të ardhurat dhe pasuritë e kërkuetit për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2016.

8. Më 19 shtator 2019, KPA-ja u përcolli palëve analizën e saj financiare (“analiza e KPA-së”). Analiza i referohej specifikisht, midis të tjerash, pamundësisë së dukshme të kërkuetit për të mbledhur mjaftueshëm kursime për pagesën e këstit në vitin 2005. Gjithashtu, ajo theksoi mospërputhjet midis të ardhurave të kërkuetit dhe shpenzimeve/pasurive të tij në vitet 2008, 2009 dhe 2011 (duke përfshirë edhe amnistinë fiskale në të ardhurat e bashkëshortes së tij).

9. Në seancën e datës 3 tetor 2019, kërkuesi paraqiti raportin e një eksperti kontabël si përgjigje ndaj analizës së KPA-së. Gjithashtu, ai paraqiti prova që mbështesnin shpjegimet e tij. Parashtrimet e tij, dyzet e shtatë faqe në total, u pranuan në dosje nga KPA-ja, që në po të njëjtën seancë e rrëzoi kërkesën e tij dhe urdhëroi kryerjen e një raporti tjetër nga eksperti.

10. Më 11 dhe 16 tetor 2019 u mbajtën dy seanca të tjera.

2. *Vendimi*

11. Më 14 tetor 2019, KPA-ja e shkarkoi kërkuetin nga detyra, për shkak se ai kishte bërë një deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasuritë e tij, sipas interpretimit të nenit D §§ 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 33(5)(b) të ligjit të *vetting*-ut (ligji nr. 84/2016).

a) Deklarim i pasaktë i Marrëveshjes së Rezervimit 2005

12. KPA-ja konstatoi se kërkuesi e kishte përmendur marrëveshjen në deklaramet vjetore të pasurisë së tij në vitet 2005 dhe 2006, por jo në deklaramin për *vetting*-un në vitin 2017. Organet e *vetting*-ut e kishin zbuluar përmbajtjen e Marrëveshjes së Rezervimit vetëm pasi kishin pyetur pranë një banke lokale, e cila kishte një kopje të marrëveshjes si pjesë e aplikimit për kredi të paraqitur nga kërkuesi në vitin 2005. KPA-ja e kishte pranuar shpjegimin e kërkuetit se ai nuk e kishte bërë plotësisht publike këtë marrëveshje, sepse më 22 korrik 2005 palët e kishin anuluar atë me anë të një akti privat, dhe kishin hyrë në negociatat komplekse, që çuan në një tjetër marrëveshje në vitin 2008 për të njëjtin apartament.

13. KPA-ja e kundërshtoi mundësinë që marrëveshja të ishte anuluar, kryesisht mbi arsyet se edhe pas anulimit të datës 22 korrik 2005, kërkuesi kishte paraqitur një kopje të Marrëveshjes së Rezervimit pranë një banke lokale me qëllimin për të marrë një kredi për blerjen e apartamentit. Gjithashtu, KPA-ja nënvizoi se pas datës së anulimit – 22 korrik 2005 – në deklaramin e pasurisë të muajit dhjetor 2006, kërkuesi kishte vijuar t’i referohej Marrëveshjes së Rezervimit. Gjithashtu, ai iu referua asaj në një marrëveshje të vitit 2008 me të njëjtën kompani ndërtimi.

b) Mospërputhje midis të ardhurave familjare të kërkuetit dhe pasurisë

14. KPA-ja identifikoi një bilanc në total negativ prej të paktën 5,804,318 lekësh (“ALL”) midis të ardhurave familjare të kërkuetit dhe shpenzimeve për vitet 2005, 2008, 2009 dhe 2011 (shih paragrafët 15, 18, 21 dhe 24 në vijim).

i. Shlyerja e këstit sipas Marrëveshjes së Rezervimit të vitit 2005

15. Sipas dispozitave në Marrëveshjen e Rezervimit të vitit 2005, kërkuesi i kishte paguar kompanisë së ndërtimit këstin prej EUR 15,130. Kërkuesi dhe kompania e ndërtimit theksuan se ajo marrëveshje ishte anuluar dhe pagesa e këstit nuk ishte bërë. Megjithatë, KPA-ja nuk ishte e bindur me argumentet e tyre dhe vijoi të shqyrtonte nëse kërkuesi kishte mjaftueshëm, të ardhura për të kursyer shumën për parapagesën brenda datës 31 maj 2005. KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuesi nuk mund ta kursente

atë shumë dhe se ai kishte një bilanc negativ prej ALL 1,641,109 (EUR 13,245 në normën e konvertimit të datës 31 maj 2005).

ii. Bilanci negativ për vitet 2008, 2009 dhe 2011

16. Kërkuesi parashtroi se gjatë periudhës në fjalë, bashkëshortja e tij, një notere publike që e ushtronte profesionin si një sipërmarrëse individuale, kishte fituar ALL 9,550,000 (rreth EUR 68,000), që u përdorën për të mbuluar shpenzimet e tyre të jetesës. KPA-ja e kundërshtoi këtë shumë me arsyetimin se të dhënat financiare të bashkëshortes tregonin se kjo shumë ishte tërhequr nga gjendja e kasës së aktivitetit si notere në vitin 2011, dhe nuk mund të jetë përdorur më herët se kjo datë. KPA-ja e rrëzoi shpjegimin e kërkuesit se ishte bërë një gabim financiar, duke theksuar se kontabilisti nuk e kishte korrigjuar gabimin menjëherë, pasi e kishte bërë këtë gabim. Gjithashtu, kërkuesi parashtroi se tërheqja e përfitimit nga një person që ushtronte profesionin si “sipërmarrës individual” ishte një veprim neutral nga pikëpamja fiskale, për këtë arsye, bashkëshortja e tij nuk i kishte kushtuar shumë vëmendje këtij aspekti.

17. Në çdo rast, KPA-ja ndoqi edhe një linjë paralele arsyetimi, sipas së cilës bashkëshortja e kërkuesit e kishte tërhequr dhe përdorur shumën e sipërpërmendur për shpenzimet e tyre familjare. Edhe në këtë rast, KPA-ja konstatoi se në vitet 2008, 2009 dhe 2011, shpenzimet/pasuritë familjare të kërkuesit i tejkalonin të ardhurat e tyre, siç detajohet në vijim.

a) 2008

18. KPA-ja konstatoi një mospërputhje prej ALL 440,782 (EUR 3,560 në normën e konvertimit të datës 31 dhjetor 2008).

19. KPA-ja e shqyrtoi dhe e rrëzoi parashtrimin e kërkuesit se ishte bërë një gabim në përlllogaritjen e pagës së tij neto dhe shpenzimet për mobilie. Sipas dietave të marra gjatë kësaj periudhe, KPA-ja konstatoi se ato i ishin dhënë kërkuesit për të mbuluar shpenzime përjashtimore dhe se ai nuk e ka pasur të mundur që t'i kursente ato.

20. Megjithatë, KPA-ja e pranoi parashtrimin e kërkuesit se disa prej udhëtimeve të tij jashtë vendit ishin bërë për arsye profesionale dhe shpenzimet ishin mbuluar nga organizatorët, dhe jo kërkuesi. Në këtë mënyrë, ajo i reduktoi shpenzimet e tij.

b) 2009

21. KPA-ja gjeti një mospërputhje prej ALL 2,911,206 (rreth EUR 21,102 në normën e konvertimit të datës 31 dhjetor 2009).

22. Thelbi i kësaj mospërputhjeje kishte lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së kërkuesit që ishte subjekt i amnistisë fiskale. Në korrik 2011, në mbështetje të ligjit të amnistisë fiskale (ligji nr. 10418), bashkëshortja e kërkuesit kishte deklaruar për herë të parë pranë autoriteteve tatimore shumën prej ALL 2,438,650 (EUR 17,670 në normën e konvertimit të datës 31 dhjetor 2009) si përfitim i gjeneruar gjatë vitit 2009, dhe i padeklaruar, për shkak të një gabimi nga kontabilisti i saj. KPA-ja gjykoi se bashkëshortja e kërkuesit kishte përfituar nga amnistia në shkelje të ligjit, sipas së cilit disa “persona” kishin detyrimin të deklarorin pasuritë e tyre pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (“ILDKPKI” – shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 202). Bashkëshortja e kërkuesit ishte familjare e një zyrtari të lartë publik dhe kishte detyrimin të deklaronte pasurinë e saj pranë ILDKPKI-së. Gjithashtu, ajo nuk mund të përfitonte nga amnistia dhe nuk është me vend që autoritetet tatimore kishin vendosur ndryshe në vitin 2011. Për këtë arsye, KPA-ja e përjashtoi këtë shumë nga të ardhurat e ligjshme familjare dhe e rrëzoi argumentin e kërkuesit se ligji i amnistisë përjashtonte nga fusha e tij e veprimit “zyrtarët” dhe jo “personat”, të cilët ishin të detyruar të deklarorin pasurinë e tyre pranë ILDKPKI-së.

23. Gjithashtu, kërkuesi parashtroi se KPA-ja duhej të mbante në konsideratë pagën që bashkëshortja e tij paguante për veten; megjithatë, KPA-ja e rrëzoi këtë argument, pasi të dhënat e saj financiare nuk paraqisnin ndonjë pagë të vetëpaguar për të për këtë vit. Për sa u përket shpenzimeve të tjera, KPA-ja përdori një qasje të ngjashme si me ato të vitit të kaluar (shih paragrafët 19–20 më sipër).

c) 2011

24. Pasi shqyrtoi argumentet e kërkuarit për pagën dhe dietat e tij, pagën e bashkëshortes së tij, shpenzimet e tij për udhëtime dhe mobilie, KPA-ja konstatoi një mospërputhje prej ALL 811,221 (EUR 5,839 në normën e konvertimit më 31 dhjetor 2011).

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Fusha e veprimit të çështjes

25. Në shkurt 2024, Qeverisë së paditur iu komunikua: ankesa e kërkuarit e bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, me argumentin se procedurat ndaj tij ishin të padrejta pasi shkelnin parimin e procedurave të kontradiktorialitetit dhe ankesa e bërë në mbështetje të nenit 8 iu komunikua Qeverisë së paditur. Ankesat e tjera u shpallën të papranueshme nga nënkryetari i Seksionit, dhe kërkuari u informua se ai vendim ishte i formës së prerë.

26. Në dhjetor 2024, në vërejtjet e tij në përgjigje të vërejtjeve të Qeverisë për ankesat e komunikuar, kërkuari: i. shtjelloi ankesat që në thelb ishin të njëjtat me ato që ishin shpallur të papranueshme; dhe ii. për herë të parë iu referua çështjeve të tjera që nuk ishin një shtjellim i ankesave të komunikuar. Këto parashtrime dëlnin jashtë qëllimit të çështjes konkrete në gjendjen aktuale, dhe Gjykata nuk do t'i shqyrtojë ato (shih *Fu Quan, s.r.o. kundër Republikës së Çekisë* [DHM], nr. 24827/14, §§ 137 dhe 144-48, 1 qershor 2023, dhe *Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë*, nr. 29943/18, §§ 75 dhe 79, 4 prill 2023).

B. Neni 6 § 1

27. Kërkuari u ankua se nuk kishte mundësinë e duhur për ta paraqitur çështjen e tij parang KPA-së, ashtu siç parashikohej nga parimi i procedurave të kontradiktorialitetit.

28. Qeveria nuk ra dakord.

29. Gjykata vëren se kërkuari ishte palë në procedurat që ishin disiplinore në natyrë dhe të mbështetura në konstatimet paraprake të faktit dhe në ligjin fillimisht të bërë nga një hetim penal dhe – në çështjen konkrete – në përfundimet e KPK-së për meritat (krahajo *Thanza kundër Shqipërisë*, nr. 41047/19, § 97, 4 korrik 2023). Në këtë mënyrë, kërkuari i duhej dhënë mundësia e duhur për të kundërshtuar këto pika të apelimit dhe ta mbronte çështjen e tij efektivisht (po aty, dhe *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, § 122, 13 dhjetor 2022).

30. Pretendimi se kërkuari nuk kishte deklaruar në mënyrën e duhur Marrëveshjen e Rezervimit 2015 u bë nga Komisioneri në apelimin fillestar dhe kërkuari ktheu përgjigje për të (shih paragrafin 4 më sipër). Gjithashtu, pretendimi se ai nuk kishte mjaftueshëm të ardhura për pasuritë/shpenzimet për vitet 2008, 2009 dhe 2011 u bë në analizën financiare të KPA-së dhe kërkuari iu kundërpërgjigj këtyre pretendimeve me anë të parashtrimeve me shkrim dhe atyre verbale në seancën e datës 3 tetor 2019 dhe në seancat e mëpasshme (shih paragrafët 8–9 më sipër).

31. Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të arritur në përfundimin – siç është kërkuar nga kërkuari – se refuzimi i KPA-së për të ndërmarrë një raport tjetër nga ekspertët shkelte parimin e procedurave të kontradiktorialitetit.

32. Në lidhje me pamundësinë e kërkuarit për t'u drejtuar pyetje ekspertëve financiarë të KPA-së, dhe për të pasur mjaftueshëm kohë për të përgatitur mbrojtjen për analizën e KPA-së, Gjykata vëren se kërkuari pati mundësinë që t'i ngrinte këto çështje pranë KPA-së gjatë procedurave vendëse dhe ato u vlerësuan në mënyrën e duhur. Vlerësimi financiar mbështetej në të njëjtat prova të shqyrtuara nga KPK-ja, dhe kërkuari iu dha mundësia e duhur për ta mbrojtur çështjen e tij me efikasitet. Gjykata nuk konstaton ndonjë arbitraritet, për këtë arsye kjo pjesë e ankesave është e papranueshme, pasi nuk mbështetet qartazi në fakte.

33. Si përfundim, kërkuari nuk gjeti ndonjë arsye specifike për shkarkimin nga detyra, gjë që e gjeti të papërgatitur, dhe nuk pati mundësinë procedurale për ta kundërshtuar atë.

34. Për rrjedhojë, ankesa në lidhje me pretendimin për mosrespektimin e parimit të kontradiktorialitetit është qartazi e pambështetuar në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

C. Neni 8

35. Kërkuesi u ankua se shkarkimi i tij nga detyra shkelte të drejtën e tij për të gëzuar jetën private.

36. Qeveria nuk ra dakord.

37. Shkarkimi i kërkuesit nga detyra ndërhynte me të drejtën e tij për respektimin e jetës së tij private dhe shkelte nenin 8 të Konventës, nëse nuk do të justifikohet se ishte në pajtim me ligjin dhe se ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim (shih *Thanzza*, cituar më sipër, § 135).

38. Kërkuesi, në mbështetje të nenit 8, riparaqiti një sërë ankesash që më herët ishin paraqitur në mbështetje të nenit 6 §1, duke përfshirë ankesën në lidhje me paanshmërinë e KPA-së, që sipas këndvështrimit të tij identifikonte problematikat me pasurinë e tij dhe më pas gjykimin për këtë gjë. Këto ankesa tashmë ishin kundërshtuar në fazën e komunikimit, dhe në kundërshtim me parashtrimet e kërkuesit, nuk e bëjnë ndërhyrjen në jetën e tij private të paligjshme. Argumentet e kërkuesit në lidhje me mungesën e një “qëllimi legjitim” të ndërhyrjes janë të ngjashme me ato që tashmë janë kundërshtuar nga Gjykata në një kontekst të ngjashëm (shih *Thanzza*, cituar më sipër, §§ 141–47, me referenca të mëtejshme). Mbetet për t’u vendosur nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale për arritjen e qëllimeve.

39. Kërkuesi u mbështet në çështjen *Sevdari* (cituar më sipër, §§ 88–97) dhe ftoi Gjykatën të vendoste se shkarkimi i tij nga detyra ishte i shpërpjesëtuar.

40. Në çështjen *Sevdari*, kërkuesi ishte shkarkuar kryesisht për problematikat me të ardhurat e bashkëshortit të saj. Në çështjen konkrete, kërkuesi u shkarkua pjesërisht, për shkak të mosdeklarimit të Marrëveshjes së Rezervimit 2005 dhe mungesës së të ardhurave për të justifikuar pagesën e kështit prej EUR 15,130. Këto fakte i atribuohen kërkuesit, më shumë sesa bashkëshortes së tij. Gjithashtu, përveç problematikave me të ardhurat e bashkëshortes së tij, KPA-ja identifikoi një bilanc negativ midis të ardhurave dhe shpenzimeve/pasurisë familjare të kërkuesit që nuk lidheshin ekskluzivisht me bashkëshorten e tij.

41. Në vijim, kërkuesi pretendonte se konstatimet faktike të KPA-së, interpretimi i legjislacionit të brendshëm dhe përfundimet ishin të pasakta. Ai theksoi se ai nuk kishte bërë pagesën e kështit në vitin 2005, se të ardhurat e bashkëshortes së tij si notere ishin të ligjshme dhe se KPA-ja i kishte ekzagjeruar shpenzimet e tij. Pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve, Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për t’i gjetur konstatimet dhe përfundimet e KPA-së si arbitrare apo qartazi të paarsyeshme. Gjykata përsërit se për qëllime të *vetting*-ut të ardhurat ose burimi i të ardhurave të një individi do të konsiderohen të ligjshme vetëm nëse ato janë deklaruar në mënyrën e duhur dhe nëse për to janë paguar tatimet (shih *Sevdari*, cituar më sipër, § 75). Në rastin kur gjykatat e brendshme kanë shqyrtuar faktet me kujdes, kanë zbatuar standardet përkatëse për të drejtat e njeriut, në përputhje me Konventën dhe praktikën e saj gjyqësore, dhe kanë balancuar në mënyrën e duhur interesat individuale me interesin publik në një çështje, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar këndvështrimin e saj me atë të gjykatave vendëse (shih *Halet kundër Luksenburgut* [DHM], nr. 21884/18, § 161, 14 shkurt 2023 dhe *Thanzza*, cituar më sipër, § 158). Për këtë arsye, shkarkimi i kërkuesit nga detyra ishte proporcional me qëllimet legjitime në rrethanat e çështjes.

42. Rrjedhimisht, ankesa e bërë sipas nenit 8 është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 16 tetor 2025.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh

KRYETARE